



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavake

A nr. 168/2014

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Ferit Osmani kryesues, Rafet Haxhaj dhe Xhevdet Abazi anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Lëvizjes Vetëvendosje (LVV) me seli në Prizren, paraqitur kundër subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) me seli në Prizren, për shkak të vendosjes së banerit të kandidatëve për deputet mbi rrugë publike, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, në seancën e panelit të mbajtur me datë 08.06.2014, mori këtë:

VENDIM

Miratohet si e bazuar ankesa e Lëvizjes Vetëvendosje (LVV) dega në Prizren, kështu që subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) dega Prizren i shqiptohet dënim me gjobë në lartësi prej 1500 (njëmijë e pesëqind) euro të cilën detyrohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita e pranimit të këtij vendimi.

Arsyetim

Me datën 05.06.2014, LVV-ja, ka parashtruar ankesë në PZAP, në të cilën ankesë pretendohet se, rreth orës 14:30 në Prizren, mbi rrugën “Remzi Ademaj” aktivistët e PDK-së kanë vendosur banerin e kandidates për deputet nga ky subjekt politik Zahrije Jusufi, veprime këto që sipas parashtruesit të ankesës janë në kundërshtim me nenin 4 paragrafi 4.1 pika (b) e Rregullës Zgjedhore nr.11/2013 si dhe neni 3.4 i Rregullës Zgjedhore 13/2014 i Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët.

Në cilësi të provës ka bashkangjitur një fotografi si dëshmi .

PZAP-i, në kuptim të nenit 4 paragrafi 3 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it dhe në kuptim të nenit 120 paragrafi 1 pika (a) të LZP-së, PZAP-i me datën 05.06.2014 e informoi subjektin politik PDK për ankesën që është bërë ndaj këtij subjekti politik duke kërkuar që të përgjigjet në Kërkesë për përgjigje dhe Urdhër për të Ndëramrrë Masa Përmirësuese, deri më datë 06.06.2014 deri në ora 17:00.

PZAP-i, e pranoi përgjigjen në ankesë sipas afatit të caktuar në të cilin theksohet se, baneri në fjalë është hequr nga aktivistët e PDK-së, si dhe janë marrë masa përmirësuese dhe është përmirësuar shkelja konform nenit 120 të LZP-së. Parashtruesi i ankesës në përgjigje në ankesë e ka bashkangjitur 1 fotografi si dëshmi nga vendi ku ka larguar banerin në fjalë.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj dhe analizoi shkresat e lëndës gjeti se:

Ankesa është e bazuar

Nga fotografia e ofruar si provë e cila gjendet në shkresat e lëndës shihet qartë se si posteri i kandidatës për deputet nga radhët e subjektit politik PDK-së Zahrije Jusufi është i vendosur mbi rrugën publike, gjë që e bënë përgjegjës PDK-në, veprim i cili

është në kundërshtim me dispozitën e nenit 33 pika (b) të LZP-së të cilat përcaktojnë veprimet e ndaluara nga ana e subjekteve politike gjatë periudhës së fushatës zgjedhore që ndalon vendosjen e njoftimeve, pllakateve, posterave si dhe të sloganeve në lidhje me fushatën zgjedhore në apo mbi rrugët publike.


Për përcaktimin e lartësisë së gjobës të vendosur në dispozitiv të këtij vendimi PZAP-i, ka marrë parasysh faktorët në vijim:

- Natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor;
- Shkallën dhe peshën e shkeljes;
- Nëse subjekti politik ka marrë pjesë në zgjedhjet e mëparshme, konsiderohet se kanë qenë të njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës;
- Nëse subjekti politik ka bërë shkelje të ligjeve zgjedhore në fuqi në këto zgjedhje apo në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë si dhe
- Shumën e fondeve të marra nga subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura më fushatën zgjedhore.

PZAP-i, mori parasysh të gjitha rr Ethanat si rëndësuese ashtu edhe rr Ethanat lehtësuese. Si rr Ethanë rënduese mori se subjekti PDK ka marrë pjesë edhe në zgjedhjet e kaluara dhe se është i njoftuar me rregullat zgjedhore, si dhe faktin se subjekti politik në fjalë ka përsëritur në zgjedhjet e kaluar dhe në këto zgjedhje shkeljen e të njëjtës natyrë, të thyerjes së kodit të Mirësjelljes për subjektet politike gjatë periudhës së fushatës zgjedhore. Ndërsa si rr Ethanë lehtësuese PZAP-i, mori se subjekti politik PDK, pas marrjes së kërkesës për përgjigje në ankesë dhe pas dhënieve së urdhrit nga PZAP-i ka ndërmarr masa për evitimin dhe përmirësimin e shkeljes së pretenduar në ankesë, siç dëshmohet nga fotografia e ofrua në përgjigje të ankesës. Andaj bazuar në nenin 118.1 dhe në nenin 120 par.1 (pika (c), vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashresa

Anr. 168/2014 më datën 08.06.2014.



Këshillë Juridike:

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatë (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoba e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5,000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.